



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:211718  
Datë: 19.12.2024  
Numri i dokumentit: 06629338  
PAKR.nr.642/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.J nga Gjilani, Rr.”Mulla Idrizi”, banesa xxx, për shkak të veprave penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 KPRK-së, dhe veprës penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit B.J, av. Djellza Mehmeti, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.96/2024, i datës 12.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 11.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit B.J, av. Djellza Mehmeti, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.96/2024, i datës 12.09.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.96/2024, i datës 12.09.2024, të akuzuarin B.J, e ka shpallur fajtor për veprën penale,

Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 KPRK, dhe veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në vijim: për veprën penale nën I/ të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, me dënim me gjobë në shumën prej 1200€ (njëmijë e dyqind euro), dhe për veprën penale nën II/ të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej 2000€ (dymijë euro). Me aplikimin e nenit 76 par. 1 dhe 2, nënpar. 2.4 të KPRK-së, i akuzuari B.J është gjykuar me dënim unik me gjobë në shumën prej 3200 € (tremijë e dyqind euro), e të cilin dënim me gjobë i akuzuari është detyruar që ta paguajë në 3 këste të barabarta mujore, për 3 muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në shumën si më lartë, atëherë gjykata në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet euro) të dënimit me gjobë do t'i llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.

I akuzuari është detyruar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarit i është konfiskuar arma e zjarrit gjysmë automatike e markës “ES EKOL”, prodhim turk, me numër serik EAS-17101181, kalibër 9mm, PA, dhe 11 (njëmbëdhjetë) fishekë me gaz.

I akuzuari është detyruar që deri në përfundimin e procedurës penale, t'a njoftoj gjykatën për çdo ndryshim të adresës.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë mbrojtësja e të akuzuarit B.J, av. Djellza Mehmeti, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Prokuroria Apelit e Kosovës, me parashtrësën me shkrim, PPA/I.nr.584/2024, të datës 07.11.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses së akuzuarit B.J, av. Djellza Mehmeti, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.96/2024, i datës 12.09.2024, të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantoi mbrojtësja e të akuzarit B.J, av. Djellza Mehmeti, ndërsa nuk prezantuan i akuzuari B.J dhe Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Mbrojtësja e të akuzuarit, B.J, av. Djellza Mehmeti pasi që elaboroi pretendimet ankimore mbështeti propozimin e parashtruar në ankesë.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses se të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa nuk është e bazuar.*

#### *Pretendimet ankimore të mbrojtëses se të akuzuarit*

Mbrojtësja e të akuzuarit B.J, av. Djellza Mehmeti, në ankesë ka theksuar se dënimi i shqiptuar ndaj të mbrojturit të saj është në kundërshtim me ligjet pozitive si të drejtës penale materiale ashtu edhe asaj procedurale. Konsideron se dënimi i shqiptuar është tejet i lartë me anë të cilit nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit i përcaktuar sipas nenit 38 të KPRK-së. Ndërsa lidhur me shqiptimin e dënimit me gjobë, mbrojtja konsideron se gjykata nuk i ka respektuar dispozitat ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, përkundër faktit se në aktgjykim ka konstatuar se vendimi është marrë mbi bazën e neneve 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë, përkatësisht rrezikshmërinë shoqërore të veprës për të cilën akuzohet i mbrojturi i saj, ndërsa si si rrethanë lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë, por nuk janë vlerësuar rrethanat tjera lehtësuese siç janë: pendimi për kryerjen e veprës penale, mosha, se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, gjendjen financiare për të përballuar lartësinë e dënimit të shqiptuar. Nga te cekurat mbrojtësja ka propozuar si më lartë.

#### *Gjetjet e Gjykatës së Apelit*

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i

njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtëses se të akuzuarit për zbutje të dënimit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, duke vepruar në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, për të akuzuarin ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë: se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, ndërsa si rrethanë rënduese ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, përkatësisht rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale. Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale, me mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprat penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtëses se të akuzuarit, si: pendimi për kryerjen e veprës penale, mosha, se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, gjendjen financiare për të përballuar lartësinë e dënimit të shqiptuar, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim tjetër nga ati të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i ishqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.642/2024, datë 11.12.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Kryetari i kolegjit

\_\_\_\_\_  
Fitore Batatina

\_\_\_\_\_  
Mentor Bajraktari

Anëtarët e kolegjit:

\_\_\_\_\_  
Afërdita Bytyçi

\_\_\_\_\_  
Valbona Musliu Selimaj